



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Bazuar në nenet 11 dhe 12, paragrafi 2 pika c, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”), Ligji Nr.08/L-067 për Inspektimet, Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Ligji Nr. 05/L-064 Për Rrugët, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës të datës 30.07.2012, Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës në mbledhjen e mbajtur me \_\_\_\_\_, pasi shqyrtoi Rregulloren mbi kriteret për vendosjen të objekteve të përkohshme në sipërfaqe dhe hapësira publike, miraton:

**PROJEKT – RREGULLORE**

**PËR SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË SIPËRFAQEVE DHE HAPËSIRAVE  
PUBLIKE**

**Neni 1**

**Qëllimi**

1. **Qëllimi** i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike, me qëllim të sigurimit të një përdorimi të rregullt, të drejtë dhe efikas të tyre, duke ruajtur interesin publik, rendin urban, sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. **Objektivat** e kësaj rregulloreje janë:
  - 2.1. Të rregullojë mënyrën e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike për persona fizikë dhe juridikë.
  - 2.2. Të sigurojë transparencë dhe barazi në trajtimin e kërkesave për shfrytëzim.
  - 2.3. Të mbrojtë hapësirat publike nga keqpërdorimi, dëmtimi apo uzurpimi.
  - 2.4. Të garantojë funksionimin normal të hapësirave për qytetarët dhe interesin e përgjithshëm.
  - 2.5. Të përcaktojë përgjegjësitë e shfrytëzuesve gjatë dhe pas përdorimit të hapësirave.
  - 2.6. Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik lokal përmes shfrytëzimit të kontrolluar të hapësirave publike.
  - 2.7. Të vendosë mekanizma për mbikëqyrjen dhe sanksionimin në rast të shkeljeve.

## Neni 2 Përkufizimet

1. **Fushëveprimi:** Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për dhënie, shfrytëzimin, mbikëqyrjen dhe revokimin e lejeve për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike në territorin e komunës.
2. **Sipërfaqe publike:** Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, janë sipërfaqet dhe hapësirat publike në të cilat Komuna ka të drejtën e administrimit, të destinuara për nevoja publike dhe me qasje të barabartë për personat fizikë dhe subjektet afariste.
3. **Sipërfaqet e përbashkëta:** Konsiderohen të gjitha hapësirat që janë në përdorim të përbashkët nga qytetarët ose shfrytëzuesit e një objekti apo zone të caktuar, të cilat nuk janë në pronësi apo përdorim ekskluziv të një personi të vetëm, dhe që shërbejnë për qarkullim, akses, qëndrim ose funksione të përgjithshme.
4. **Objekte të përkohshme:** Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, konsiderohen të gjitha ato objekte të cilat nuk mund të vendosen si të përhershme e që janë të ndërtuara nga materiali i lehtë montues, e që sipas nevojës për implementim të Hartës Zonale të Komunës apo Planeve Rregulluese të Hollësishme, do të iniciohet largimi i tyre.
5. **Hapësirë publike e uzurpuar:** Konsiderohet çdo pjesë e hapësirës publike që shfrytëzohet, zëhet apo përdoret nga persona fizikë ose juridikë pa leje nga organi kompetent, ose në kundërshtim me kushtet e lejes së dhënë, duke kufizuar apo penguar përdorimin e lirë dhe të barabartë të saj nga publiku.
6. **Leje administrative:** Është akt zyrtar i lëshuar nga organi kompetent i komunës, me të cilin i jepet e drejta një personi fizik apo juridik për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, në përputhje me kushtet, kriteret dhe afatet e përcaktuara në këtë rregullore dhe në legjislacionin në fuqi.
7. **Leje për shfrytëzim të përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike:** Është akti administrativ, të cilin e nxjerr Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.
8. **Revokimi i lejes:** Është akt i organit kompetent me të cilin ndërpritet ose anulohet vlefshmëria e lejes së dhënë për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, para përfundimit të afatit të saj, për shkak të mosrespektimit të kushteve të lejes ose dispozitave të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.
9. **Operatorët ekonomikë:** Konsiderohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike, përfshirë prodhimin, tregtinë ose ofrimin e shërbimeve me qëllim përfitimi dhe që aplikojnë ose përfitojnë të drejtën për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

10. **Objektet e përkohshme:** Janë struktura, pajisje ose instalime të vendosura në hapësirat publike për një periudhë të kufizuar kohore, të cilat nuk kanë karakter të përhershëm dhe mund të largohen pa dëmtuar hapësirën apo infrastrukturën përkatëse.
11. **Shitës ambulant:** Konsiderohen individët që nuk disponojnë ndonjë vend të caktuar për shitjen e gjësendeve, por që veprimtarinë shitëse të lejuar e ushtrojnë duke lëvizur nga një vend në tjetrin.
12. **Shfrytëzimi i parkingjeve nga bizneset:** Lejohet vetëm në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organi kompetent i komunës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.
13. **DPU:** Nënkupton Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm.
14. **DI:** Nënkupton Drejtorinë për Inspeksion.

### **Neni 3** **Klasifikimet**

1. Objektet e përkohshme, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, janë klasifikuar dhe përcaktuar në këto tri kategori klasifikimi:
    - 1.1. Klasifikimi reklamues:** Reklamata klasifikohen sipas formës, përmbajtjes dhe mënyrës së vendosjes në hapësira publike, si më poshtë:
      - 1.1.1. **Reklama statike** – tabela, pankarta, bilborde dhe struktura të ngjashme të palëvizshme.
      - 1.1.2. **Reklama ndriçuese** – reklama me ndriçim të brendshëm ose të jashtëm, përfshirë ekranet LED.
      - 1.1.3. **Reklama digjitale** – reklama që shfaqen nëpërmjet ekraneve elektronike me përmbajtje të ndryshueshme.
      - 1.1.4. **Reklama të përkohshme** – reklama të vendosura për një periudhë të caktuar, zakonisht për ngjarje, fushata ose promovime.
      - 1.1.5. **Reklama të lëvizshme** – reklama të vendosura në automjete ose mjete të tjera transporti.
    - 1.2. Klasifikimi tregtar:** Është ndarja e veprimtarive ekonomike të operatorëve ekonomikë në kategori të ndryshme sipas natyrës së aktivitetit, llojit të mallrave apo shërbimeve që ofrojnë, si dhe mënyrës së ushtrimit të tregtisë.
- Në përgjithësi, veprimtaritë tregtare mund të klasifikohen në:
- 1.2.1. **Tregti me pakicë** – shitja e mallrave drejtpërdrejt konsumatorit final.
  - 1.2.2. **Tregti me shumicë** – furnizimi i bizneseve të tjera me mallra në sasi të mëdha.
  - 1.2.3. **Shërbime tregtare** – ofrimi i shërbimeve me qëllim fitimi.
  - 1.2.4. **Tregti ambulante** – shitja e mallrave në hapësira të përkohshme ose të lëvizshme.

1.2.5. **Tregti online** – shitja e mallrave dhe shërbimeve përmes platformave elektronike.

**1.3. Klasifikimi shërbyes/argëtues:** I referohet ndarjes së veprimtarive që ofrojnë shërbime me karakter argëtues, rekreativ ose kulturor për publikun, me qëllim argëtimin, relaksim dhe zhvillimin social-kulturor të qytetarëve.

Në këtë klasifikim përfshihen zakonisht:

1.3.1. **Shërbime argëtimi** – aktivitete si lojëra, lojëra elektronike, kinema, teatro dhe aktivitete të ngjashme.

1.3.2. **Shërbime rekreative** – parqe lojërash, qendra sportive dhe aktivitete të kohës së lirë.

1.3.3. **Shërbime kulturore dhe evente** – organizimi i koncerteve, festivaleve dhe manifestimeve publike.

1.3.4. **Shërbime të mikpritjes dhe argëtimit** – lokale, klube dhe hapësira të tjera për argëtim publik.

2. Varësisht nga destinimi që mund t'i bëhet sipërfaqes apo hapësirës së caktuar publike, për vendosjen, apo në rast nevojë zhvendosjen e tyre, konsiderohen këto objekte:
  - 2.1. Kioskat, deri në 10 m<sup>2</sup>;
  - 2.2. Bankomatet, deri në 6 m<sup>2</sup>;
  - 2.3. Butik-postat;
  - 2.4. Kamp-shtëpizat, deri në 8 m<sup>2</sup>;
  - 2.5. Strehët për pritje të autobusëve, deri në 10 m<sup>2</sup>.
3. Për vendosje të objekteve siç janë: Kioskat, bankomatet, butik-postat, kamp-shtëpizat dhe hapësirat para lokaleve në pronësi të Komunës, lejimi i shfrytëzimit të sipërfaqes i referohet dispozitës së nenit 5, paragrafi 1.2, të Rregullores Komonale për Shërbime Publike Nr. 28 të datës 06.02.2026, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se 1 vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Objekte të përkohshme lëvizëse, sezonale dhe ekspozuese konsiderohen:
  - 4.1. Tavolinat dhe karriget të cilat vendosen në hapësirat pranë lokaleve shërbyese hoteliere (restoranteve, kafeneve);
  - 4.2. Pajisjet për shitje të akulloreve;
  - 4.3. Pajisjet për shitjen e misrit, gështenjave, patateve të skuqura (pomfritit), brumërave të ndryshme etj.
  - 4.4. Stendat lëvizëse për shitjen e kartolinave, panoramave, fotografive artistike, librit joshkollor;
  - 4.5. Konstruksionet për lojëra cirku;
  - 4.6. Lojëra të ndryshme për fëmijë;
  - 4.7. Ombrellat hijezuese – me mekanizëm;
  - 4.8. Mbulesat fikse-statike (me konstruksion druri dhe metalik), tendat (çadrat) e hapura me mekanizëm lëvizës, stendat lëvizëse;
  - 4.9. Frigoriferët (frizat) dhe automjetet lëvizëse për shitje të ushqimit të shpejtë;

- 4.10. Gjeneratorët statikë për furnizim me energji alternative;
- 4.11. Automjetet dhe mjetet për ekspozim, si dhe objekte të tjera të përkohshme lëvizëse dhe sezonale.

#### **Neni 4**

### **Procedura e aplikimit dhe digjitalizimi**

1. Aplikimi për leje për vendosjen e objekteve të përkohshme bëhet përmes platformës elektronike të Komunës ose në formë fizike.
2. Të gjitha lejet regjistrohen në sistemin elektronik për menaxhimin e hapësirave publike.
3. Komuna mban regjistër publik të të gjitha lejeve të lëshuara.

#### **Neni 5**

1. Vendosja e objekteve nga neni 3 i kësaj rregulloreje lejohet nëse janë plotësuar këto kushte:
  - 1.1. Të mos cenohen sipërfaqet e trotuareve me gjerësi më të vogël se 2 m.
  - 1.2. Në udhëkryqet e rrugëve të mos zvogëlohet pamja dhe të mos rrezikohet siguria në trafik.
  - 1.3. Të mos pengohet lëvizja e këmbësorëve dhe çiklistëve.
  - 1.4. Të respektohet distanca nga rrugët publike konform Ligjit për rrugët.
  - 1.5. Të mos pengohet shfrytëzimi normal i objekteve ekzistuese (para hyrjes së objekteve, lokaleve, shkallëve, parkingjeve të rezervuara për persona me nevoja të veçanta).
  - 1.6. Ndalohet në mënyrë restriktive vendosja e objekteve në hapësirat gjelbëruese.

#### **Neni 6**

### **Standardet minimale urbane dhe teknike**

1. Vendosja e objekteve të përkohshme duhet të respektojë standardet minimale si në vijim:
  - distanca minimale ndërmjet objekteve: 3 (tre) metra
  - distanca nga rruga publike: minimum 1.5 (një presje pesë) metra

- mos pengimi i qasjes për këmbësorë dhe persona me aftësi të kufizuara
2. Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm është e obliguar të zbatojë standarde unike për dizajn dhe vendosje të objekteve.

### **Neni 7**

Madhësia, pamja dhe kushtet urbano-teknike të lokacionit për vendosje të objekteve të përkohshme nga neni 3 i kësaj rregulloreje përcaktohen nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, dhe mbikëqyren nga Drejtoria e Inspeksionit.

### **Neni 8**

1. Ndalohet ndërrimi i destinimit apo ndryshimi i veprimtarisë nga ajo që është lejuar nga organi kompetent, si dhe ndryshimi i madhësisë apo pamjes së objektit në kundërshtim me kushtet e dhëna urbano-teknike, pa pëlqimin apo lejen e Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm.
2. Shfrytëzuesi i objektit të përkohshëm është i detyruar që veprimtarinë ta ushtrojë personalisht, në pajtueshmëri me lejen e lëshuar për vendosje të objektit, si dhe në bazë të Certifikatës mbi regjistrimin e biznesit.

### **Neni 9**

Në aktin administrativ mbi lejimin e shfrytëzimit të përkohshëm të sipërfaqes për vendosje të objektit, të përcaktohet se në rast të hartimit të projektit nga Komuna, shfrytëzuesi i sipërfaqes të bëjë largimin e objektit në afat prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e marrjes së njoftimit për largim. Në të kundërtën, urdhërlargimi ekzekutohet nga Komuna në ngarkim të shpenzimeve të shfrytëzuesit të sipërfaqes publike.

## **II. MBISHKRIMET (FIRMAT), PANOT, BANERËT MBI RRUGË DHE TABELAT REKLAMUESE**

### **Neni 10**

1. Mbishkrim apo firmë konsiderohen të gjitha shënimet identifikuese të veprimtarisë afariste, të vendosura në hapësirat mbi derën e hyrjes së objektit apo të shkruara në vitrinat e lokaleve afariste.
2. Firma duhet të përmbajë: Titullin e biznesit, adresën e selisë ku zhvillohet biznesi, si dhe shënime të tjera identifikuese si: Numri i telefonit, faksi, e-maili etj.
3. Çdo përsëritje e shënimeve të cekura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, pavarësisht madhësisë, formës së shkrimit, formës së vendosjes së tyre, vendit të shkrimit apo vendit të vendosjes, e shkruar dhe e vendosur në sipërfaqe publike apo sipërfaqe individuale, me qëllim të reklamimit të veprimtarisë afariste, do të konsiderohet si reklamë, pano reklamuese apo tabelë reklamuese.
4. Panot, tabelat reklamuese dhe banerët mbi rrugë mund të vendosen vetëm në bazë të lejes së lëshuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtoria për Infrastrukturë dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, sipas kërkesës së pronarit të biznesit, sipas afatit kohor të precizuar paraprakisht në kërkesë. Për banerët mbi rrugë duhet respektuar lartësia e vendosjes, min.= \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>.
5. Në një kërkesë mund të përfshihen një apo më tepër reklama, tabela reklamuese, për çka pagesa bëhet për secilën reklamë të vendosur.
6. Për reklamat dhe tabelat reklamuese disa krahësh, pagesa bëhet për secilin krah dukshëm.
7. Për reklamat dhe tabelat reklamuese (ndriçuese), pagesa është e njëjtë sikurse për reklamë të thjeshtë (jo ndriçuese).
8. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet:
  - 8.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 8.2. Certifikata e biznesit;
  - 8.3. Leja e punës;
  - 8.4. Taksa komunale.

## **Neni 11**

1. Për vendosje të reklamës, panos reklamuese dhe tabelës reklamuese sipas lejes së DPU-së, vlera për tarifë përcaktohet sipas zonës kadastrale, si dhe kohëzgjatja – vjetore apo periudha e caktuar sipas kërkesës:
  - 1.1. Zona e parë (përfshin zonën kadastrale urbane);
  - 1.2. Zona e dytë (përfshin të gjitha fshatrat).

## **Neni 12**

**Ekranet elektronike reklamuese, tabelat reklamuese me kinoprojektor dhe tabelat reklamuese digjitale**

1. Për vendosje të ekraneve elektronike reklamuese, tabelave reklamuese me kinoprojektor dhe tabelave reklamuese digjitale, leja lëshohet nga DPU.  
Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet:
  - 1.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit të biznesit;
  - 1.2. Certifikata e biznesit;
  - 1.3. Skica e lokacionit;
  - 1.4. Atesti teknik dhe elektronik;
  - 1.5. Statika dhe pesha e ekranit.
2. Për vendosje të ekraneve elektronike reklamuese, tabelave reklamuese me kinoprojektor dhe tabelave reklamuese digjitale, pagesa bëhet për secilën zonë të qytetit, si në vijim:
  - 2.1. Në zonën Qendra, pagesa për ekran elektronik reklamues është 7.00 € për m<sup>2</sup> për një muaj, kurse jashtë qendrës 5.00 € për m<sup>2</sup> për një muaj.
  - 2.2. Tabela reklamuese me kinoprojektor është 7.00 € për m<sup>2</sup> për një muaj.
  - 2.3. Tabela reklamuese digjitale është 7.00 € për m<sup>2</sup> për muaj.

### **Neni 13**

#### **Pllakatet reklamuese, bilbordet, city-light-et, panot murale dhe banerët**

1. Pllakata reklamuese konsiderohen sipërfaqet në të cilat ekspozohen reklamimet për biznese, që kanë dimensione 4x3 landscape gjithmonë, e që njihen ndryshe si pano reklamuese për marketing, që përfshijnë:
  - 1.1. Bilbordet;
  - 1.2. City-light-et;
  - 1.3. Panot murale;
  - 1.4. Banerët.
2. Ky lloj i reklamave i referohet lokacioneve brenda zonës së qytetit (nëpër sipërfaqe gjelbëruese dhe në afërsi të kryqëzimit të rrugëve), si dhe jashtë zonave të qytetit (përballë rrugëve magjistrale apo rajonale).
  - 2.1 Të përcaktohet vendosja murale me dimensione variante.
3. Kërkesës për vendosjen e këtyre reklamave duhet t'i bashkëngjitet:
  - 3.1. Kopja e letërnjoftimit;
  - 3.2. Certifikata e biznesit;
  - 3.3. Pëlqimi njoftues nga ministria përkatëse;
  - 3.4. Atesti statik dhe i qëndrueshmërisë (stabilitetit);
  - 3.5. Skica e lokacionit;
  - 3.6. Taksa komunale;
  - 3.7. Vërtetimi i tatimit në pronë.

4. Organizatat e ndryshme jofitimprurëse, të cilat vendosin përkohësisht pllakata përmes të cilave organizojnë manifestime të ndryshme për qëllime humanitare, lirohen nga pagesa e tarifës për vendosjen e tyre.
5. Për vendosje dhe reklamim në objekte reklamuese, pagesa e tarifës është:
  - 5.1. Për bilborde: 7.00 € për m<sup>2</sup> në muaj;
  - 5.2. Për city-light: 5.00 € për m<sup>2</sup> në muaj;
  - 5.3. Për panot murale: 5.00 € për m<sup>2</sup> në muaj;
  - 5.4. Për banerë: 5.00 € për m<sup>2</sup> në muaj.
6. Përzgjedhja e përfituesve për vendosje të pllakatave reklamuese në objekte reklamuese nga neni 11 bëhet përmes konkurrencës së hapur dhe publike.
7. Përfituesit sipas konkurrimit publik i lejohen 2–3 pika për reklama si (bilbord, city-light) për organizatat e ndryshme jofitimprurëse.
8. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar për vendosje dhe mbajtje të tyre, operatori obligohet që në afat kohor jo më të gjatë se 15 ditë të bëjë largimin e tyre.

#### **Neni 14**

##### **Strehët për pritje të autobusëve**

1. Vendosja e strehëve për pritje të autobusëve bëhet në bazë të kushteve të lokacionit, të lejuara nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, si dhe të pëlqimit nga DSHPI-ja.
2. Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë planin kartografik të pikave të planifikuara për vendosje të strehëve për pritje dhe dizajnin e tyre.

#### **Neni 15**

##### **Kioskat**

1. Kioskat janë objekte të përkohshme të tipit montues/demontues, të punuara nga materiali i lehtë ndërtimor si: druri, plastika, metali, apo duke i kombinuar këto materiale, me sipërfaqe deri në 10 m<sup>2</sup>.
2. Kioskat duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë standarde për shitje vetëm përmes sportelit.
3. Nuk lejohet vendosja e kioskave apo rikthimi eventuale i tyre në shëtitoren kryesore – zona këmbësore (pedestriane) e cila përkufizon tërë hapësirën publike (dizajnimi sipas projektit aktual nga Komuna).
4. Pagesa për sipërfaqen e lejuar për vendosje të kioskës është 7.00 € për m<sup>2</sup> për muaj.

5. Hapësira e lejuar e shfrytëzimit nga veprimtaritë afariste për vendosjen e tavolinave është maksimumi 6 metra nga vija ndërtimore, duke mos e cenuar nenin 16 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 16**

#### **Vendosja e tavolinave dhe karrigeve në hapësirat pranë lokaleve shërbyese hoteliere**

1. Për vendosjen e tavolinave dhe karrigeve në sipërfaqe publike pranë lokaleve që ushtrojnë veprimtari shërbyese të gastronomisë, kërkesës i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 1.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 1.2. Certifikata e biznesit;
  - 1.3. Leja e punës;
  - 1.4. Taksa komunale;
  - 1.5. Vërtetimi i tatimit në pronë.
2. Leja për vendosje të këtyre objekteve do të lëshohet për periudhën kohore nga data 1 mars deri më datën 30 shtator, që konsiderohet si periudhë sezonale. Gjithashtu, edhe për muajt në vijim, nëse e shfrytëzojnë hapësirën publike, do të paguhet taksa sipas rregullores së miratuar.
3. Tarifa për vendosje të tavolinave dhe karrigeve në këto sipërfaqe paguhet sipas zonave të qytetit:
  - 3.1 Zona e parë: 6.00 €, m<sup>2</sup>në muaj;
  - 3.2 Zona e dytë: 4.50 €, m<sup>2</sup>në muaj;
  - 3.3 Zona e tretë: 3.30 €, n<sup>2</sup> në muaj.

### **Neni 17**

#### **Sipërfaqet dhe hapësirat gjelbëruese**

1. Sipërfaqe dhe hapësira gjelbëruese, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, konsiderohen të gjitha ato sipërfaqe publike që janë të gjelbëruara si: bari, lulet, drurët etj.
2. Sipas madhësisë dhe pozitës së tyre, këto sipërfaqe apo hapësira konsiderohen si parqe, oaza gjelbëruese (hapësirat në kuadër të shesheve apo ndërtesave shumëbanesore) dhe ishuj gjelbërues (hapësirat në kuadër të trotuareve).
3. Në këto hapësira nuk lejohet vendosja e asnjë objekti.

### **Neni 18**

#### **Detyrimet për mbrojtjen e mjedisit**

1. Subjektet që shfrytëzojnë hapësirat publike janë të obliguara të:

- mbajnë pastërtinë e hapësirës përreth
  - menaxhojnë mbeturinat
  - mos shkaktojnë ndotje akustike apo mjedisore
2. Përdorimi i gjeneratorëve dhe pajisjeve të tjera lejohet vetëm nëse plotësojnë standardet e zhurmës dhe sigurisë.

### **Neni 19**

#### **Sipërfaqet dhe hapësirat publike me destinim të veçantë (trotuaret, sheshet dhe tregjet)**

1. Me dispozita të kësaj rregulloreje është përcaktuar vija rregullative e hapësirave publike në trotuare, shëtitore dhe sheshe, për lëvizje të papenguar të qytetarëve në relacion me hapësirën e cila mund të lejohet për ushtrim të veprimtarisë afariste të përkohshme.
2. Hapësira për lëvizje të papenguar të qytetarëve, në kuadër të trotuareve, përcaktohet në 1/3 (një e treta) e gjerësisë së hapësirës publike – trotuarit.
3. Pjesa e mbetur prej 2/3 (dy të tretat) e gjerësisë së sipërfaqes publike – trotuarit lejohet për vendosjen e objekteve vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
4. Në pjesët e trotuareve me gjerësi deri në 2m nuk lejohet vendosja e objekteve.

### **Neni 20**

#### **Kontrata për shfrytëzim të hapësirave publike**

1. Leja për shfrytëzim të hapësirave publike shoqërohet me kontratë ndërmjet Komunës dhe përfituesit.
2. Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë:
  - afatin e shfrytëzimit
  - mënyrën e pagesës
  - kushtet për ndërprerje

## **Neni 21**

### **Rishikimi i tarifave**

1. Tarifat e përcaktuara me këtë rregullore rishikohen çdo vit nga Komuna.
2. Rishikimi bëhet në bazë të analizës së tregut dhe zhvillimeve ekonomike.

## **Neni 22**

### **Stendat e hapura lëvizëse**

1. Vendosja e stendave të hapura lëvizëse për shitjen e gjësendeve si: Libri joshkollor, fotografitë artistike, panoramat, lodrat për fëmijë dhe koncerte, lejohet në hapësirë maksimale deri në 8 m<sup>2</sup>.
2. Për vendosjen e këtyre stendave, kërkesës duhet t'i bashkëngjitet:
  - 2.1. Kopja e letërnjoftimit;
  - 2.2. Fotografia e lokacionit;
  - 2.3. Taksa komunale;
  - 2.4. Vërtetimi i tatimit në pronë.
3. Pagesa për vendosjen e stendave të hapura lëvizëse bëhet sipas zonave të qytetit:
  - 3.1. Zona e parë: 1.50 € për m<sup>2</sup>për një ditë;
  - 3.2. Zona e dytë: 1.30 € për m<sup>2</sup>për një ditë;
  - 3.3. Zona e tretë: 1.20 € për m<sup>2</sup> për një ditë.
4. Është e lejuar vendosja e këtyre stendave vetëm për një sezon të caktuar dhe leja është e kufizuar në kohë vetëm për shitjen e gjësendeve të cilat nxirren në treg për festat e fillimvitit apo në fundvit, siç janë: Kartolinat për Vitin e Ri, bredhat për dekorim, dhuratat për festat e marsit etj.

### **Neni 23**

#### **Vendosja e pajisjeve për shitje të akulloreve**

1. Për vendosjen e pajisjeve si: Autofrigoriferët apo frigoriferët statikë për shitje të akulloreve dhe pijeve freskuese, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 1.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 1.2. Skica e lokacionit;
  - 1.3. Certifikata e biznesit;
  - 1.4. Kërkohet pëlqimi nga inspeksioni sanitar.
2. Pagesa për vendosjen e autofrigoriferit dhe frigoriferit statik paguhet:
  - 2.1. Për një autofrigorifer: 70.00 € për një muaj;
  - 2.2. Frigorifer statik për akullore: 50.00 € për një muaj.

### **Neni 24**

#### **Vendosja e pajisjeve për shitje të misrit, gështenjave, patateve të skuqura (pomfritit), petullave, krepave (pancakes) dhe artikujve të ngjashëm**

1. Vendosja e pajisjeve (aparateve) për shitje të këtyre artikujve lejohet vetëm në bazë të kushteve të lokacionit, të cilat i përcakton Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, dhe pëlqimit nga Drejtoria e Inspeksionit për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare.
2. Vendosja e këtyre pajisjeve lejohet vetëm në 1–2 m<sup>2</sup> sipërfaqe.
3. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 3.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 3.2. Skica e lokacionit;
  - 3.3. Certifikata higjieno-sanitare ose pëlqimi higjieno-sanitar, kurse për shitësit e farave, gështenjave, misrit, kikirikëve si dhe produkteve të këtij lloji, kjo certifikatë nuk kërkohet;
  - 3.4. Pëlqimi nga inspeksioni sanitar.
4. Pagesa për vendosjen e këtyre pajisjeve bëhet në vlerë prej 50.00 € për një muaj.

### **Neni 25**

#### **Vendosja e automjetit lëvizës për shitje të ushqimit të shpejtë**

1. Automjet lëvizës për shitje të ushqimeve të shpejta konsiderohen:
  - 1.1. Autodyqani lëvizës;
  - 1.2. Kioska lëvizëse.
2. Vendosja e këtij lloji të objekteve është për afat të kufizuar kohor:
  - 2.1. Për një ditë apo disa ditë gjatë manifestimeve të ndryshme, panairëve, organizimit të lojërave;
  - 2.2. Në periudhë sezonale deri në 3 (tri) muaj brenda një viti kalendarik.

3. Kërkesës për vendosje të këtij lloji të objekteve duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 3.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 3.2. Certifikata e biznesit;
  - 3.3. Pëlqimi mbi kushtet higjieno-sanitare nga inspeksioni sanitar;
  - 3.4. Certifikata mbi kualifikimin përkatës për këto shërbime;
  - 3.5. Taksa komunale;
  - 3.6. Vërtetimi i tatimit në pronë.
4. Pagesa për vendosjen e këtyre objekteve bëhet sipas zonave të qytetit:
  - 4.1. Zona e parë: 70.00 € për një muaj;
  - 4.2. Zona e dytë: 55.00 € për një muaj;
  - 4.3. Zona e tretë: 45.00 € për një muaj.

### **Neni 26**

#### **Vendosja e tendave (çadrave) lëvizëse me mekanizëm**

1. Vendosja e këtyre tendave lejohet për:
  - 1.1. Bizneset që ushtrojnë veprimtari shërbyese të gastronomisë;
  - 1.2. Bizneset që ushtrojnë veprimtari tregtare;
  - 1.3. Aktivitete për OJQ, aktivitete fetare dhe të ndryshme.
2. Për vendosjen e këtyre tendave, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 2.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 2.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
  - 2.3. Fotografia e lokacionit.
3. Nuk lejohet vendosja e çadrave në hapësirat publike ku mund të pengohet lëvizja e qytetarëve, si dhe vendosja e atyre që ndikojnë negativisht në pamjen dhe imazhin e lokacionit ku vendosen.

### **Neni 27**

#### **Terasat para lokaleve afariste**

1. Terasat duhet të jenë të harmonizuara sipas formës dhe pozitës së lokalit afarist, si dhe duhet të jenë fleksibile për nga forma.
2. Aplikimi për vendosjen e terasave të mbyllura, si dhe terasave nga materiali montues-demontues me mbështjellës nga plastika apo qelqi, fillon nga 1 tetori deri më datën 28 shkurt, që konsiderohet si periudhë sezonale (vjeshtë-dimër).
3. Aplikimi për vendosjen e terasave të mbyllura, me material montues-demontues me mbështjellës nga plastika apo qelqi, bëhet për periudhën më pak se 1 (një) vit.

4. Qëndrimi i konstruksionit metalik të terasave të hapura në hapësirat publike i nënshtrohet pagesës vetëm për konstruksion, për shkak të pengesave të cilat i krijon konstruksioni për lëvizjen e qytetarëve, gjë që do të tarifohet sipas zonave.
5. Vendosja e këtyre terasave lejohet deri në 4 m gjatësi për:
  - 5.1. Bizneset që ushtrojnë veprimtari shërbyese hoteliere;
  - 5.2. Bizneset që ushtrojnë veprimtari tregtare;
  - 5.3. Aktivitete për OJQ-të, aktivitete fetare dhe të ndryshme.
6. Kërkesës për vendosjen e këtyre terasave duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 6.1. Kopja e letërnjoftimit;
  - 6.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
  - 6.3. Fotografia e lokacionit.
7. Pagesat për vendosjen e terasave të mbyllura me tavolina në këto hapësira bëhet sipas zonave të qytetit:
  - 7.1. Zona e parë: 7.00 € për m<sup>2</sup>për muaj;
  - 7.2. Zona e dytë: 5.00 € për m<sup>2</sup>për muaj;
  - 7.3. Zona e tretë: 3.50 € për m<sup>2</sup>për muaj.
8. Pagesa për qëndrimin e konstruksionit të terasave të mbyllura në këto hapësira jashtë sezone bëhet sipas zonave të qytetit:
  - 8.1. Zona e parë: 3.00 € për m<sup>2</sup> për muaj;
  - 8.2. Zona e dytë: 1.80 € për m<sup>2</sup> për muaj;
  - 8.3. Zona e tretë: 1.50 € për m<sup>2</sup> për muaj.

## **Neni 28**

### **Vendosja e lojërave për fëmijë, siç është ngasja e automjeteve lodra**

1. Vendosja e lojërave për fëmijë lejohet vetëm në hapësira të cilat i përcakton Drejtoria për Shërbime Publike. Aplikimet bëhen në fillim të vitit. Të interesuarit duhet të aplikojnë deri më 01.03 të vitit vijues, kurse varësisht nga numri i aplikuesve, përzgjedhja bëhet përmes hedhjes së shortit.
2. Kërkesës për vendosjen e këtyre lojërave duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 2.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 2.2. Certifikata e biznesit;
  - 2.3. Fotografia e lokacionit.;
  - 2.4. Atesti teknik për disa lloje të lojërave.
3. Pagesa për vendosjen e lojërave bëhet sipas zonave të qytetit, ku përjashtohet në tërësi zona e parë:

- 3.1. Zona e dytë: 3.00 € për m2 për muaj;
- 3.2. Zona e tretë: 2.70 € për m2 për muaj.

### **Neni 29**

#### **Mbrojtja e qasjes publike dhe personave me aftësi të kufizuara**

1. Vendosja e objekteve të përkohshme nuk duhet të pengojë qasjen e lirë dhe të sigurt për këmbësorët dhe personat me aftësi të kufizuara.
2. Çdo vendosje që pengon qasjen konsiderohet shkelje dhe trajtohet sipas dispozitave ndëshkuese të kësaj rregulloreje.

### **Neni 30**

#### **Vendosja e gjeneratorëve statikë**

1. Vendosja e gjeneratorëve statikë lejohet me afat kohor për 1 (një) vit, me të drejtë vazhdimi.
2. Kërkesës për vendosjen e gjeneratorëve statikë duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 2.1. Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
  - 2.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
  - 2.3. Specifikat e gjeneratorit (lloji);
  - 2.4. Vërtetimi zyrtar i mbrojtjes nga rreziqet, çdo 3 (tre) vjet;
  - 2.5. Vërtetimi zyrtar për sigurinë nga zhurma;
  - 2.6. Fotografia e lokacionit;
  - 2.7. Taksa komunale;
  - 2.8. Vërtetimi i tatimit në pronë.
3. Pagesa për vendosjen e gjeneratorit statik bëhet në vlerë prej 10.00 € për m2 për muaj.

### **Neni 31**

#### **Vendosja e veturave për ekspozim me qëllim promovimi të lojërave shpërblyese**

1. Kërkesës për vendosjen e automjetit për ekspozim duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 1.1. Kopja e letërnjoftimit;
  - 1.2. Certifikata e biznesit;
  - 1.3. Fotografia e lokacionit;
  - 1.4. Taksa komunale;
  - 1.5. Vërtetimi i tatimit në pronë.

2. Pagesa për vendosjen e veturave për ekspozim bëhet në vlerë prej 7.00 € për 1m2 për muaj, në të gjitha zonat e qytetit.

### **Neni 32**

#### **Shfrytëzimi i hapësirave pranë lokaleve afariste në të cilat ushtrohet veprimtari tregtare**

1. Pronarëve apo shfrytëzuesve të lokaleve që ushtrojnë veprimtari tregtare kryesisht me mallra ushqimore, tekstili apo materiale të tjera që janë lehtë të dëmtueshme, nuk u lejohet ekspozimi i hapur i këtyre mallrave.
2. Lejohet vendosja apo ekspozimi i këtyre artikujve vetëm në vitrina të mbyllura, kurse akti për lejimin e vendosjes së vitrinave të mbyllura në hapësirën publike pranë lokaleve lëshohet nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.
3. Për këtë lloj të vitrinave, pagesa bëhet sipas zonave:
  - 3.1. Zona e parë: 5.00 € për m2 për muaj;
  - 3.2. Zona e dytë: 4.00 € për m2 për muaj;
  - 3.3. Zona e tretë: 3.00 € për m2 për muaj.

### **Neni 33**

#### **Kufizimi i numrit të lejeve**

1. Për qëllim të ruajtjes së rendit urban dhe funksionalitetit të hapësirave publike, Komuna përcakton numrin maksimal të lejeve për vendosjen e objekteve të përkohshme për secilën zonë.
2. Numri maksimal i lejeve përcaktohet me vendim të veçantë nga organi kompetent, duke u bazuar në:
  - kapacitetin e hapësirës publike
  - qarkullimin e qytetarëve
  - interesin publik
3. Në rast se arrihet numri maksimal i lejeve, kërkesat e reja refuzohen ose trajtohen përmes procedurave konkurruese.

### **Neni 34**

1. Akti i lëshuar për vendosjen e objekteve të përkohshme mund të revokohet (tërhiqet) edhe para skadimit të afatit të lejuar, nëse:
  - 1.1. Paraqitet nevoja për realizimin e planit rregullues urban të hollësishëm;
  - 1.2. Ka ankesa eventuale nga qytetarët për pengimin të lëvizjes së lirë të këmbësorëve.
2. Anulimi apo shfuqizimi i aktit nga paragrafi paraparak i kësaj rregulloreje bëhet me vendim të cilin e sjell organi që e ka lëshuar lejen.
3. Afati i caktuar për largimin e objektit është 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pranimit të vendimit.
4. Ankesa kundër vendimit për largim nuk e shtyn ekzekutimin.
5. Nëse pronari nuk e largon objektin brenda afatit të caktuar në vendim, largimi do të bëhet nga Komuna në ngarkim të shpenzimeve të bartësit të lejes.
6. Vlera e mbetur e mjeteve të paguara pas largimit të objektit nuk kthehet.

## **III. DISPOZITAT NDËSHKUESE DHE KALIMTARE**

### **Neni 35**

1. Pas përfundimit të çdo kontrolli, inspektori me anë të procesverbalit konstaton gjendjen faktike dhe urdhëron subjektin afarist që brenda një afati të caktuar të mënjanojë parregullsitë e konstatuara.
2. Inspektori me anë të procesverbalit do të urdhërojë largimin e të gjitha objekteve të përkohshme, të përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje, në këto raste:
  - 2.1. Nëse objektet janë vendosur pa marrë parapakisht lejen nga organi kompetent, respektivisht pa vazhduar lejen pas skadimit të saj.
  - 2.2. Nëse me rastin e vendosjes së objekteve nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara me lejen e lëshuar nga organi kompetent.
  - 2.3. Nëse pronari apo shfrytëzuesi i hapësirës publike nuk ka vepruar sipas procesverbalit apo aktvendimit të inspektorit kompetent me të cilin është urdhëruar mënjanimi i parregullsive të konstatuara brenda afateve të caktuara.
3. Nëse edhe pas afatit të caktuar nga inspektori personi nuk i ka evituar parregullsitë, atëherë ndaj tij do të shqiptohet dënimi mandator konform kësaj rregulloreje.
4. Nëse edhe pas shqiptimit të gjobës, personi juridik apo fizik vendos objekte në hapësirat publike pa lejen e organit kompetent, ato objekte do të sekuestrohen dhe ndaj të njëjtit do të iniciohet procedura në gjykatën kompetente.

5. Objektet e sekuestruara do të vendosen në depot në menaxhim të Komunës deri në përfundim të procedurës gjyqësore.
6. Në rast të dëmtimit gjatë sekuestrimit, organi kompetent nuk merr përgjegjësinë për mallin e sekuestruar.

### **Neni 36**

#### **Dispozitat ndëshkimore**

1. Me gjobë mandatore në shumën prej 300 € do të gjobitet personi juridik apo fizik i cili vendos objekte në hapësirat publike pa marrë paraprakisht leje nga organi kompetent, respektivisht pa e vazhduar lejen paraprake pas skadimit të afatit.
2. Në rast të zbatimit të masave të largimit të objekteve të përkohshme, pllakatave reklamuese, bilbordeve, city-light-eve, panove murale dhe banerëve, pronarit apo shfrytëzuesit të objektit do t'i ngarkohen shpenzimet e krijuara gjatë largimit, gjegjësisht sekuestrimit të objekteve, dhe i njëjti do të humbë të drejtën që në të ardhmen t'i jepet leje për vendosjen e objekteve të përkohshme në hapësirat publike.

### **Neni 37**

#### **Neni-Procedura e inspektimit dhe masave administrative**

Në rast të konstatimit të shkeljeve, inspektori kompetent ndërmer këto masa në mënyrë të shkallëzuar:

- paralajmërim me shkrim
- caktim afati për përmirësim (3 deri në 7 ditë)
- shqiptim i gjobës
- urdhër për largim
- Aktvendim për rrënim

Në rast të mosrespektimit të afatit, Komuna realizon largimin e objektit me shpenzimet e subjektit.

### **Neni 38**

#### **Mbikëqyrja dhe zbatimi**

Përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje janë: Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, Drejtoria për Inspeksion, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 39**  
**Hyrja në fuqi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret e mëparshme.

**Neni 40**

Kjo rregullore shpallet 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS**  
**KUVENDIT**

**01-Nr-\_\_\_\_\_ , më \_\_\_\_\_.**

**KRYESUESI I**

**Vlonjat Hasani**

---